



Viti i VIII-të i Botimit, Nr.1,
Korrik 2017

DËSHMIA E DËSHMITARIT DHE TAKTIKA E PYETJES SË TIJ PËR RINDËRTIMIN E PORTRETIT TË AUTORIT TË VEPRËS PENALE

Fatmir Tartale

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University, Shqipëri

Adresë kontakti: fatmirtartale@gmail.com

Përmbledhje

Në praktikën e punës së organeve të procedimit penal lind nevoja e identifikimit të autorit të një veprë penale, në bazë të tipareve të jashtme, i cili pas kryerjes së veprës penale i fshihet hetimeve paraprake të drejtuar nga prokurori. Identifikimi i autorit të veprës penale, si një element i procesit të të provuarit, si dhe mjetet e metodat e përdorura, bëhet referuar veçorive të çdo rasti identifikimi që do të paraqitet para organeve të procedimit penal. Për kërkimin dhe identifikimin e autorit, ndër mjetet që përdoren për identifikim si daktiloskopia, antropometria, metodës së ADN-së, fotografia sinjalistike etj. Sipas rastit, ndihmon edhe pyetja e dëshmitarëve të rritur apo të mitur, e të dëmtuarve që kanë qenë të pranishëm kur ka ndodhur një veprë penale në një ambient të caktuar dhe që kanë parë autorin duke kryer veprën penale apo duke u larguar nga vendi i krimit pas kryerjes së tij. Ata do të merren në pyetje, nëse kanë fiksuar në kujtesë tiparet e tij dhe veçoritë e këtyre tipareve apo shenja dalluese, që janë: karakteristika të natyrës juridike (emri, mbiemri), karakteristika fizike (pamja personale me shenja të veçanta); karakteristika faktike (dita, muaji, viti i lindjes) (1). Këto shërbejnë më pas për identifikimin që do të kryhet në vazhdim të procedimit penal, për të identifikuar, zbuluar, kapur, e vënë para përgjegjësie penale, autorin e veprës penale, të kryer apo të mbetur në tentativa.

Fjalë çelës: *prokuror, i dëmtuar, autor, dëshmitar, proces penal, identifikim, pyetje, tentativë, kujtesë.*

TESTIMONY OF THE WITNESS AND THE TACTIC OF HIS QUESTIONING TO RECONSTRUCT THE PERPETRATOR'S PROFILE OF THE CRIMINAL OFFENSE

Abstract

In the usual working practice of criminal prosecution bodies it becomes necessary to identify the perpetrator of a criminal offense, based on external features, who after committing the criminal offense, absconds the preliminary investigation conducted by the prosecutor. Identification of the perpetrator of a certain criminal offense, as an element of proof process, as well as the means and methods used, is conducted by reference to the features of each identification case, which will appear before the criminal prosecution authorities. For the

search and identification of the perpetrator, among the tools used for identification such as: dactyloscopy, anthropometry, DNA method, signaling photography, etc. , as appropriate, it also helps questioning of the adult or minor witnesses, of the injured party who have been present when the criminal offense occurred in a specific setting and who have noted the perpetrator committing the criminal offense or escaping the crime scene, already after committing it. They will be subject to questioning, if they have fixed in their memory features and characteristics of these features or other distinctive signs, which are: . . . legal nature characteristics (name and surname), physical characteristics (personal appearance with special signs); factual characteristics (day, month, year of birth) . . . 1) that later will serve for the identification to be subsequently performed of the criminal proceeding, to identify, detect, capture, and put before the criminal responsibility, the perpetrator of the committed or attempted criminal offense.

Key words: *prosecutor, injured party, perpetrator, witness, criminal proceeding, identification, questioning, search, attempt, memory.*

Hyrje

Pyetja e dëshmitarëve apo të dëmtuarve, si një veprim procedural për marrjen e provave në procesin penal, është një veprim i rëndësishëm që kryhet nga organet e procedimit penal, sipas fazës së procedimit, që nga ndodhja e ngjarjes, pra e veprës penale, e deri në gjykimin e çështjes nga gjykata.

”Nga vëzhgimi i një skenë krimi dikush mund të dëshmojë apo të tregojë karakteristikat e sjelljes së personit përgjegjës” (2). Pra, veç sa sipër, pyetja e dëshmitarëve e të dëmtuarve është sa një veprim proceduralo-penal edhe një proces psikik, pasi veprimtaria psikike e dëshmitarit apo të dëmtuarit për ndërtimin e portretit të autorit të një vepre penale, në përgjithësi zhvillohet në këto faza: perceptimi i tipareve, fiksimi i tyre në kujtesë, riprodhimi i modelit të fytyrës së personit të parë prej tyre nëpërmjet shenjave të tij të veçanta. Të gjitha këto procese psikologjike krijojnë në vetëdijen e dëshmitarit pamjen e subjektit të perceptuar më parë prej tij, gjë që u intereson organeve të hetimit paraprak, policisë gjyqësore e prokurorit dhe gjykatës në fazën e shqyrtimit gjyqësor, për të identifikuar autorin e veprës penale.

Perceptimi dhe fiksimi në kujtesë

“Perceptimi përmbledh në vetvete një sërë procesesh përmes të cilave në arrijmë të njohim, organizojmë dhe kuptojmë sensacionet, ngacmimet apo informatat që marrim nga stimulimi i mjedisit, i cili tërheq për një kohë vëmendjen tonë” (3). Siç dihet, kujtesa si një proces i ndërlikuar na jep aftësinë për të fiksuar, ruajtur dhe aktualizuar informata, ngjarje apo procese që kanë ndodhur në të kaluarën. Figura e çdo personi, dhe në mënyrë të veçantë e autorit të një krimi, lë tek dëshmitari gjurmë, sepse ngacmon poret e hemisferave të mëdha të trurit të tij. Këto gjurmë mbartin mundësinë e ngacmimit të përsëritur edhe më vonë, madje edhe gjatë mungesës së ngacmimit që e shkaktoi atë. Në qoftë se gjatë perceptimit të drejtpërdrejtë fiksohet pamja e përgjithshme e njeriut, që vepron duke ngacmuar organet e shqisave në një moment të caktuar, kujtesa e plotëson atë.

1. Përveç tipareve të fytyrës, një informacion të rëndësishëm për pamjen e jashtme të personit japin shtati, moshja dhe shenjat.

Bazat fiziologjike të veprimtarisë mendore për krijimin e portretit të autorit të panjohur, janë

lidhjet e përbëra, të cilat bashkojnë pjesëzat e perceptuara. Lidhjet formohen nën ndikimin e nxitjes dhe lindin kur personi i vë detyrë vetes rikujtimin mendor të figurës së autorit që ka parë duke montuar, elementet tipikë të pamjes së jashtme, që i ka perceptuar drejtpërdrejtë ai vetë. Në zhvillimin e gjithë këtij procesi të ndërtuar, për perceptimin dhe fiksimin e portretit të autorit në kujtesën e dëshmitarit, ndikojnë një sërë faktorësh, ndër kryesorët e të cilëve janë:

mundësitë fizike të perceptimit, prania e shumë njerëzve në vendin e ngjarjes, gjendja e keqe e motit me shi, borë dhe erë, gjendja e kohës së errët, ndriçimi i dobët i mjedisit, etj., ndikojnë negativisht në perceptimin dhe krijimin e përfytyrimit të plotë të pamjes së jashtme të autorit. Në perceptimin e shenjave të pamjes së jashtme të personit, një influencë të madhe ka edhe distanca që nga vëzhgohet ai. Kështu njerëzit me shikim normal dhe në kushte të mira vëzhgimi, e dallojnë njeriun nga objektet e tjera në largësinë 2 km, lëvizjet e duarve dhe të këmbëve të tij në 700 m, kapelet në 400 m, kokën, supet, konturet e fytyrës dhe ngjyrën e veshjes në 300 m, fytyrën dhe duart në 200 m, dhe në largësinë 60 m dallohen sytë, hunda e gishtërinjtë, ndërsa 20 m afër dallohen të gjitha tiparet dhe detajet e fytyrës.

Kohëzgjatja e vëzhgimit dhe shpejtësia e perceptimit. Dëshmitari kur e shikon autorin vetëm në një çast, nuk mund të perceptojë të gjitha hollësitë e pamjes së jashtme, mbasi mundësia e përqendrimit të vëmendjes në elementet përbërës të fytyrës së autorit është e kufizuar. Veprimet kriminale zakonisht kryhen në mënyrë të papritur për dëshmitarët dhe zhvillohen shumë shpejt, gjë që vështirëson mundësinë e reflektimit të menjëhershëm të tij dhe të perceptimit të plotë të pamjes së autorit. Gjithashtu, kur dëshmitari e ka parë autorin edhe para kryerjes së veprës penale, jep të dhëna më të plota dhe të përpikta, për shenjat e pamjes së jashtme të tij.

Pozicioni i dëshmitarit në raport me autorin. Kur dëshmitari gjatë kohës së vëzhgimit, ka qenë në pozicion nga ku shihet i gjithë territori në të cilin vepron fajtori, e shikon atë përballë ose në pozicionin 3/4 e kthimit të kokës, mund të fiksojë mirë autorin. Ky pozicion është më i përshtatshëm për vëzhgim dhe për t'u mbajtur mend, sepse në praktikën e përditshme njerëzit, në përgjithësi, e shikojnë njëri-tjetrin përballë. Megjithatë, nuk duhen nënvleftësuar thëniet e dëshmitarëve që e kanë parë autorin në profil.

Gjendja dhe shkalla e ndjeshmërisë së organeve të të parit të dëshmitarit. Perceptimet bazohen para së gjithash në ndjeshmërinë e shqisave. Njeriu nëpërmjet ndijimeve arrin të perceptojë formën e plotë të objekteve duke nxjerrë kuptimin e tyre. Perceptimi pra është një tërësi e pandashme e ndijimeve me të menduarit, e shqisave me racionalen. "Syrit tonë i bashkohen jo vetëm shqisat e tjera, por edhe veprimtaria e mendjes sonë" (4). Për pasqyrimin e pamjes së jashtme të fajtorit në ndërgjegjen e dëshmitarit, rol të madh luajnë ndijimet. Njerëzit që kanë një shkallë të mirë ndjeshmërie të organeve, janë të aftë të perceptojnë e të pasqyrojnë në mënyrë të plotë e të saktë pamjen e jashtme të personit që kanë parë. Nga studimet e shkallës së ndjeshmërisë së të parit rezulton se një njeri me të parë normal, në errësirë, në distancën 1 km ndjen një dritë prej 1000 qirinjsh. Shpejtësia e perceptimit të fytyrës në fotografi është 0.03 sek, ndërsa elementet e veçantë të saj dallohen për flokët, 0,035 sek, vetullat 0.09 sek, balli 0.06 sek, sytë 0.08 sek, veshët 0.09 sek, hunda 0.1 sek, buzët 0.14 sek, mjekra 0.12 sek etj. Siç shihet, nga të dhënat e mësipërme del se perceptimi i elementeve të fytyrës bëhet nga lart poshtë dhe në njësi të vogla kohe. Ndjeshmëria e të parit mund të ndryshojë nën veprimin e ngacmimeve të jashtme.

Nga eksperimentet e disa psikologëve është konstatuar se ndjeshmëria e të parit ngrihet nga ftohja e pakët e lëkurës dhe nga tingujt jo të fortë, ndërsa ulet ndaj ngjyrës së kuqe dhe forcohet nga ngjyra jeshile dhe e kaltër. Po kështu, në ndjeshmërinë e të parit një influencë të madhe ka përshtatja në errësirë dhe në dritë. Përshtatja në errësirë rrit aftësinë për të parë dhe për të menduar karakteristikat e fytyrës së njerëzve që ndodhen atje. Me kalimin nga drita në errësirë duhet ca kohë që njeriu t'i

përshtatet kushteve të reja, ndërsa nga errësira në dritë duhet një kohë më e madhe.

Tek disa njerëz, negativisht ndikojnë edhe defektet e të parit, si miopia e daltonizmi (paaftësia për të parë disa ngjyra, më shumë të kuqen dhe jeshilen). Kështu, njerëzit miopë, në qoftë se nuk përdorin syze, me anën e të cilave korrigojnë të parët, nuk mund t'i shohin tiparet e fytyrës së njeriut që ndodhet larg nga ata në një distancë të caktuar (në vartësi nga shkalla e miopisë), kurse ata që vuajnë nga daltonizmi, mund t'i përcaktojnë të deformuara ngjyrën e flokëve, të syve, të fytyrës etj.

Gjendja e përgjithshme psiko-fiziologjike e dëshmitarit. Më mirë i përcaktojnë figurat e realitetit objektiv, midis tyre dhe figurat e njerëzve, ata dëshmitarë të cilët në momentin e vëzhgimit e ndjejnë veten të qetë. Kur dëshmitari, në momentin e vëzhgimit, ndodhet në gjendje të pirë ose në tronditje të fortë psikike të shkaktuar nga sulmi i autorit të armatosur, mund të krijojë në ndërgjegjen e tij një përfytyrim jo të qartë e të deformuar të figurës së autorit. Në perceptimin që bën dëshmitari, si rregull, lind një i mbajtur mend spontan e i pavullnetshëm i tipareve të autorit, e diktuar kjo nga situata e veçantë e krijuar nga ngjarja, por jo rrallë takohen dëshmitarë që e kanë parë autorin para se ai të kryejë krimin. Tek këta dëshmitarë, është karakteristike të mbajturit mend jo spontan i pamjes së jashtme të fajtorit, por një i mbajtur mend i vullnetshëm. Ky lloj të mbajturit mend, në krahasim me atë spontan të pavullnetshëm, natyrisht është më i vlefshëm.

Në procesin e pyetjes së dëshmitarit, për ndërtimin e portretit të autorit të panjohur, oficeri i policisë gjyqësore apo prokurori, duhet të sqarojnë e të vlerësojnë, jo vetëm kushtet objektive të perceptimit të pamjes së autorit, por edhe faktorët subjektivë, të cilët mund të ndikojnë në perceptimin, të mbajturit mend dhe riprodhimin e pamjes së jashtme të autorit.

Rruajtja në kujtesë e figurës së perceptuar varet nga qartësia e perceptimit të saj dhe qëllimi i dëshmitarit. Në qoftë se dëshmitari ka parë mirë, i ka fiksuar tiparet e jashtme të autorit dhe e kupton rëndësinë që kanë thëniet e tij, atëherë, pa dyshim, do të riprodhojë më qartë figurën e fajtorit. Gjithashtu shkalla e ruajtjes në kujtesë e figurave të objekteve të perceptuara varet edhe nga jashtëzakonshmja e tyre. Pa dyshim, e jashtëzakonshme, e rëndësishme për cilindo, është figura e personit që vëzhgohet, gjatë kryerjes së një veprë penale. Fiziologjikisht kjo dukuri bazohet në atë që perceptimi i dëshmitarit transmeton një nxitje të fortë në koren e hemisferave të mëdha të trurit ku formohen lidhje të thella nervore, të cilat lënë “gjurmë” më të forta sesa veprimet e ngacmuesve të zakonshëm. Ky fakt, padyshim reflekton në mënyrë të favorshme për qartësinë e përfytyrimeve të dëshmitarit lidhur me figurën e personit që hetohet. Harresa e figurës së perceptuar e personit që hetohet, sipas ligjeve objektive të psikikës, bëhet në mënyrë jo proporcionale. Nganjëherë, pas perceptimit, harresa zhvillohet shpejt, por pastaj tempi i saj ngadalësohet. Për këtë flasin qartë rezultatet e studimeve eksperimentale: Mbas 1/2 orë, 1 orë, 9 orë, 24 orë, 40 orë, 144 orë, 744 orë. Riprodhohet 59 për qind, 44 për qind, 36 për qind, 34 për qind, 28 për qind, 25 për qind, 21 për qind. Prandaj, është mjaft e kuptueshme, formën më të plotë të pamjes së jashtme të autorit, mund ta kujtojë ai i dëmtuar ose dëshmitar, i cili pyetet menjëherë ose fill mbas vëzhgimit të tij.

Shpejtësia e harresës në një masë të madhe varet nga interesimi i personit për informacionin e perceptuar. Dëshmitari që ka vëzhguar autorin gjatë kryerjes së një veprë penale ose menjëherë mbas saj, si rregull, shpesh kujtohet, mendon për të, duke dënuar njëkohësisht veprimin kriminal të tij. Ky aktivizim i vëmendjes, i shërben dëshmitarit që të mos harrojë figurën e shkelësit të ligjit. Kujtesa figurative ose kujtesa me përfytyrime, në dallim nga llojet e tjera të kujtesës emocionale dhe asaj lëvizëse, gjithashtu, ndihmon të mbajturit mend dhe riprodhimin e pamjes së jashtme të autorit, që e ka parë gjatë kryerjes së një veprë penale. Zhvillimi më i madh i atij ose këtij lloji të kujtesës, është i lidhur, siç dihet, me veçoritë tipike të veprimtarisë së lartë nervore, në punë ku jo vetëm që shfaqet por edhe formohet. Kështu, kujtesa figurative, zakonisht është karakteristike

për piktorët, fotografët, skulptorët, shkrimtarët etj.

Cilësitë e kujtesës karakterizohen nga shpejtësia e të mbajturit mend, nga qëndrueshmëria e ruajtjes dhe nga lehtësia e riprodhimit. Njerëzit me kujtesë të mirë kujtojnë shpejt dhe harrojnë ngadalë të perceptuarën, ndërsa ata me kujtesë të keqe kujtojnë ngadalë dhe harrojnë shpejt. Por kujtesa ka edhe një karakter zgjedhës, kujtohet lehtë dhe është e qëndrueshme nga çdo njeri, ajo që i përgjigjet interesave dhe kërkesave të tij. Në përfytyrimet e kujtesës për pamjen e jashtme të fajtorit, ndikon edhe aftësia e veçantë e çdo njeriu për përfytyrim. Përfytyrimi i pasur ndihmon që perceptimet të riprodhohen më të plota dhe të qarta, por cilësia e pasqyrimin të elementeve të veçantë të pamjes së jashtme me këtë humbet. Përfytyrimi i varfër pengon perceptimin e plotë të të gjitha detajeve të personit në kompleks, megjithatë, në kushte të mira vëzhgimi tek njerëzit me përfytyrim të varfër, në kujtesë formohen përfytyrime të sakta për elemente të veçantë të pamjes së jashtme. Pasuria, format dhe realiteti përfytyrimin varet edhe nga eksperiencia e jetës, profesioni i dëshmitarit, niveli dhe përgatitja e tij, e interesave, e ndjenjave emocionale, e prirjes e të vëmendjes, e gjendjes së shëndetit të tij dhe e sistemit nervor. Njerëzit me përvojë të vogël jetësore, që zotërojnë bagazh të paktë dijes, me vullnet të dobët, të pavëmendshëm e të papërqendruar, përfytyrimi i të cilëve kontrollohet pak nga të menduarit, janë të prirur për fantazi boshe, për dhënie të figurave, jo reale, etj. Cilësia e të mbajturit mend të kësaj ose asaj figure duket në riprodhimin e përfytyrimin.

Riprodhimi

Në psikologji, me riprodhim, kuptohet procesi i rindërtimit në kujtesë, të asaj që është perceptuar, më parë, kur i pyeturi, dëshmitar apo i dëmtuar, pas perceptimit dhe kujtesës, riprodhon në formën e dhënieve të fakteve që ka parë apo dëgjuar. Ai, si dhe procese të tjera të kujtesës, në shumë gjëra varet nga përvoja e jetës së dëshmitarit, e personalitetit të tij, e synimit, e rëndësisë së figurës së perceptuar, etj.” Baza fiziologjike e riprodhimit është rigjallërimi i lidhjeve të përkohshme nervore, të cilat janë vendosur gjatë procesit të të mbajturit mend.” (5). Po ashtu, dhe riprodhimi i gjurmëve të ngacmimit të mëparshëm në koren e trurit. Gjatë riprodhimit të figurës ideale të autorit të veprës penale, që ekziston në mendjen e dëshmitarit, gjurmët e vatrave të nxitjes, gjallërohen nën veprimin e sinjaleve të dyta të ngacmimeve. Riprodhimi dhe të mbajturit mend është e vullnetshme dhe e pavullnetshme. Për ndërtimin e portretit të autoritet të panjohur të veprës penale, shfrytëzohet rikujtesa e pavullnetshme. Gjatë kujtesës së figurës ideale të autorit, dëshmitari ndonjëherë kujton me vështirësi detaje të veçanta të pamjes së jashtme të tij, procesi i rindërtimit të figurës ecën ngadalë dhe kërkon përqendrim në atë që është perceptuar. Ndërtimi i portretit të autorit të panjohur mbaron me përshkrimin e dëshmitarit të pyetur, kohë në të cilën duhet të ndërtohet, portreti i autorit të panjohur edhe me anën e mjeteve teknike. Gjatë përshkrimit verbal, tiparet e figurës së autorit, dalin më qartë në kujtesën e dëshmitarit, sepse gjatë kësaj kohe ndodh aktualizimi i perceptimeve dhe përfytyrimeve të mëparshme, prandaj duhen shfrytëzuar me kujdes gjatë pyetjes. Por, që të japësh përshkrimin me gojë, të veçorive të pamjes së jashtme të autorit, të karakterizosh me përpikëri elementet e fytyrës së tij, është një detyrë e vështirë për dëshmitarin e zakonshëm. Madje dëshmitarët që e kujtojnë pamjen e jashtme të autorit, ndjejnë vështirësi në përshkrimin verbalisht të kësaj pamjeje. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ata e kujtojnë keq autorin, nuk dinë të bëjnë portretin e tij, e për rrjedhojë, ta njohin atë. Paaftësia për të përshkruar sendin, nuk përjashton mundësinë e njohjes së tij, ashtu si dhe përshkrimi i drejtë nuk siguron mundësinë e njohjes. Gjatë ndërtimit të portretit të autorit të panjohur, para dëshmitarit vihet detyrë që të kujtojë e të shprehë me gojë pamjen e jashtme të autorit, duke e përqendruar vëmendjen në pjesët e veçanta të fytyrës së perceptuar. Në veprimin e këtij ngacmuesi të veçantë, siç është të folurit, sistemi i dytë i sinjaleve, tek dëshmitari në koren

Dëshmia e dëshmitarit dhe taktika e pyetjes së tij për rindërtimin e portretit të veprës penale

e hemisferave të trurit, gjallërohen vatrat e nxitjes nervore, të lindura gjatë perceptimit të autorit. Nën ndikimin e aktualizimit të lidhjeve nervore, në përfytyrimet për pamjen e përgjithshme fizike të autorit, për kontrollin e fytyrës së tij, për flokët dhe elemente të veçantë të fytyrës. Në këtë mënyrë, në ndërgjegjen e dëshmitarit krijohet modeli i fytyrës së autorit, i cili përdoret për ta krahasuar me figurën e përshkruar dhe vetë portretin e ndërtuar të fajtorit të panjohur.

Taktika e pyetjes së dëshmitarit

Riprodhimi me kujdes i pamjes së jashtme të personit të panjohur, autor i dyshuar e një vepre penale të kryer apo të mbetur në tentative, me anë të metodave të ndërtimit të portretit të tij, varet jo vetëm në shumë gjëra, jo vetëm nga plotësia dhe qartësia e perceptimit dhe të mbajturit mend nga dëshmitari, por edhe nga metodat e përdorur nga oficeri i policisë gjyqësore e prokurori, për aktivizimin e përfytyrimeve dhe të kujtesës së dëshmitarit, për pamjen e jashtme të fajtorit. “Identifikimi i autorit të veprës penale arrihet në procesin e hetimit me përdorimin e veprimeve të tjera hetimore si pyetja, kontrollimi, njohja, ekspertimi etj.” (6). Gjatë pyetjes së dëshmitarit për riprodhimin e figurës së autorit, oficeri i policisë gjyqësore e prokurori, duhet të ketë parasysh gjendjen e tij fizike e psikike. Nga lodhja, nga dobësimi i sistemit nervor, nga sëmundjet, nga konfliktet në punë, në familje etj., dëshmitari mund të jetë i paafte në një moment të caktuar, të riprodhojë në kujtesë, figurën e autorit. Ndërsa mbas një kohe, mbasi zhduken këto rrethana, ai mund të zgjidhë me sukses këtë detyrë. Gjatë pyetjes për ndërtimin e portretit të fajtorit të panjohur, për ta ndihmuar për rikujtimin e figurës dhe të pamjes së jashtme të tij, dëshmitarit i bëhen pyetje plotësuese, për ta ndihmuar që të bëjë një përshkrim të hollësishëm të karakteristikave dhe të pamjes së jashtme të autorit. Taktika e pyetjes duhet të synojë në aktivizimin e veprimtarisë mendore të dëshmitarit, të ndihmojë të kujtuarit e madhësisë, formës, ngjyrës dhe veçorive të pamjes së jashtme të autorit. Tek njerëz të ndryshëm, në sajë të veçorive individuale të formimit psikik, gjallërimi i figurës të autorit është i ndryshëm. Disa dëshmitarë rindërtojnë mirë në kujtesë detaje të pamjes së jashtme të autorit, gjatë paraqitjes së figurave ose vizatimeve të elementeve të njëjtë, ndërsa të tjerët përkundrazi, pamjet e paraqitura të fytyrës, jo vetëm që nuk i ndihmojnë të kujtojnë figurën e perceptuar më parë, por edhe çorientojnë. Në vartësi të kësaj, jo të gjithë dëshmitarëve duhet t’ju paraqiten figura e vizatime të pamjes së jashtme të personit për të cilin dyshohet se është autori i veprës penale. Aftësia për të gjetur ngjashmërinë dhe ndryshimin nëpërmjet sendeve dhe dukurive të perceptuara të realitetit, përcaktohet nga shkalla e zhvillimit të veprimtarisë analizuese dhe sintetizuese të trurit të personit.

Dëshmitari që zotëron kujtesë figurative, që di të merret me analizë dhe sintezë, di të ndajë në pjesë figurën e autorit, në elemente përbërës, bën krahasimin e këtyre figurave, me figurat e detajeve të pamjes së jashtme që i paraqiten dhe krijon nga ato, modelin material të fytyrës së ngjashme me atë të autorit. Ndërsa ka dëshmitarë që nuk kanë përvojë në bërjen e operacioneve mendore analizuese e sintetizuese, të cilët e kanë të vështirë të zgjidhin pozitivisht detyrën e formimit të portretit të autorit të panjohur. Për të patur sukses në ndërtimin e portretit të autorit të panjohur, oficeri i policisë gjyqësore e prokurori duhet të dijë më parë se sa të zhvilluar e ka dëshmitari funksionin analitiko-sintetik të të menduarit. Kjo gjë mund të sqarohet në rrugë eksperimentale, duke i paraqitur dëshmitarit një fotografi (portret), të cilën, organi i procedimit e vendos midis fotografive të tjera dhe të gjitha së bashku ia paraqet dëshmitarit për të parë nëse ai do të gjejë fotografinë eksperimentale që iu dha. Ky eksperiment mund të kryhet edhe ndryshe, duke iu afuar sa më shumë kushteve reale. Në vend të fotografisë dëshmitarit i paraqitet një njeri që s’ka lidhje me çështjen që hetohet, pamja e jashtme e të cilit duhet të dallohet nga pamja e jashtme e personit që dyshohet, sepse, në rast të kundërt, mund të bëhet përzierja e strukturave të figurave të autorit, me atë të pjesëmarrësit në eksperiment dhe të ngatërrohet dëshmitari. Duke

njohur proceset e perceptimit, të fiksimit në kujtesë dhe të riprodhimit të tipareve të fytyrës, organi i procedimit penal është në gjendje të ndërtojë një taktikë të drejtë të pyetjes së dëshmitarit, apo të dëmtuarit, për ndërtimin e portretit të autorit.

Mbi bazën e përshkrimit që bën dëshmitari apo i dëmtuari, organi i procedimit penal, krijon portretin e autorit, të cilin e krahason vetë ose ia kërkon dëshmitarit, duke i paraqitur atij fotografi, pamje të filmuara me video ose vetë personin për njohje, bazuar në kërkimet e nenit 171-175 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (7). Referuar Legjislacionit Procedural Penal Shqiptar por edhe Kodit të Procedurës Penale Italiane nga është orientuar legjislacioni ynë procedural penal, që e kanë sistemin procedural penal akuzator- inkuizitor si edhe ne, në nenet 213-217 ku trajtohet “Njohja” (8), edhe në kërkimet e këtyre dispozitave procedurale penale, ligjvënësit kanë parashikuar veç pyetjes së dëshmitarëve edhe njohjen e personit si provë që merret nga organi i procedimit, por që është i lidhur ngushtë me shpjegimet e dëshmitarit që e ka njohur, ka individualizuar ose ka përcaktuar të dhënat apo shenjat që ai mban mend të autorit të veprës penale. Në këto dispozita procedurale penale në të dy legjislacionet, janë parashikuar rregullat se si kryhet njohja nga organi i hetimit paraprak apo gjykata se kur bëhet njohja e personit, ftesa që i bëhet dëshmitarit që do të bëjë njohjen, përshkrimin prej tij të personit të dyshuar, karakteristikat, shenjat që mban mend dhe nëse e ka bërë më parë njohjen etj. Në nenin 171/3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 213/3 të Kodit të Procedurës Penale Italiane, është parashikuar që, nëse nga organi i procedimit nuk respektohen kërkimet e parashikuara nga paragrafi 1 dhe 2 në këto dispozita proceduralo-penale, është shkak pavlefshmërie e njohjes, parashikim të cilin nuk e gjejmë të parashikuar, në nenin 120 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të parashikuar “Identifikimi i personave” (9), për deklarimin e pavlefshmërisë së marrjes së kësaj prove, nga organi i provedimit penal në hetimin paraprak, pavarësisht se trajtohet me detaje kryerja e identifikimit të autorit nga dëshmitari. Pra nga organet e procedimit kërkohet korrektesë maksimale në kryerjen e njohjes së autorit të dyshuar, nga dëshmitari që thirret për ta njohur, por nëse nuk respektohen detyrimet ligjore, veprimi i kryer, pavarësisht nga rezultati pozitiv apo negativ i njohjes së realizuar, nuk do të shërbejë si provë, pasi është i pavlefshëm, pavlefshëmëri e cila mund të deklarohet nga gjykata, pasi asaj i paraqitet kërkesa nga pjesëmarrësit, në marrjen e kësaj prove, jo më pak e rëndësishme se të tjerat të parashikuara në nenin 149 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë (10), për individualizimin e autorit të dyshuar. Studimi i këtyre metodave dhe shfrytëzimi i tyre në praktikë, ndihmon për gjetjen dhe identifikimin e autorit të veprës penale, i cili largohet nga vendi i ngjarjes dhe i shmanget përgjegjësisë ligjore.

Natyrisht, që të kemi sukses në zbulimin e autorit, pyetja e dëshmitarëve apo të dëmtuarve, dhe taktika e pyetjes së tyre, duhet të kryhet duke respektuar me rigorozitet legjislacionin proceduralo-penal, me qëllim që çdo veprim për identifikimin e autorit të panjohur, të jetë i vlefshëm për hetimin paraprak dhe më pas për gjykimin e autorit të veprës penale, që pas identifikimit e mbledhjes së provave të mjaftueshme, do të vihet para akuzës së ngritur kundër tij nga organi i akuzës, duke respektuar kërkesat e së drejtës të në procesi të rregullt ligjor, në zbatim të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (11).

Në legjislacionin procedural penal thëniet e dëshmitarëve, përfshi këtu dhe të dëmtuarit, përbëjnë një nga burimet e provave në procesin e të provuarit. Gjatë marrjes së të dhënave e fakteve nga dëshmitari apo i dëmtuari nga vepra penale, në procesin e riprodhimit ndikojnë faktorë të ndryshëm, që nga vendosja e kontaktit psikologjik ndërmjet organit procedues në hetimin paraprak, oficerit të policisë gjyqësore e prokurorit dhe të pyeturit, vëzhgimi sjelljes që manifeston ai, sugjestionimi dhe fantazia në shpjegime. Pra, që nga ndërtimi i marrëdhënieve, i një bisede të përshtatshme ndërmjet tyre gjatë pyetjes, dëgjimi me vëmendje dhe drejtimi i pyetjeve normale, në lidhje

me ç'ka i ka ndodhur vetë atij, si kur është i dëmtuar apo çka parë në ngjarjen e ndodhur, duke u munduar që të evitohen, shqetësimet e krijuara nga ngjarja dhe përshtypja që mund të ketë dëshmitari apo i dëmtuari, si rezultat i veprës penale të ndodhur.

Veçojmë këtu pyetjet sugjестive, të cilat, sipas legjislacioneve procedurale penale të ndryshme evropiane, ballkanike e më gjerë deri në SHBA, ndalohen pyetjet që servirin përgjigje apo ndikojnë keq në paanësinë e dëshmitarit. Kështu, në Kodet e Procedurës Penale të Shqipërisë të viteve 1959 dhe 1998 nuk kanë ndonjë dispozitë procedurale të shprehur për të kufizuar pyetjet sugjестive, ndërsa Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë të vitit 1995 në nenin 361/3 është parashikuar ndalimi i tyre duke përcaktuar se "Ndalohen pyetjet që ndikojnë keq në paanësinë e dëshmitarit ose që synojnë në sugjerimin e përgjigjeve" (12).

Edhe në Kodin e Procedurës Penale Italiane që ka shërbyer si referim për legjislacionin tonë procedural penal, në nenin 499/2 të tij është parashikuar ndalimi i këtyre pyetjeve; pyetjet që mund të dëmtojnë sinqeritetin e përgjigjeve" dhe në nenin 499/3 është përcaktuar se "ndalohen pyetjet që synojnë sugjerimin e përgjigjeve" (13). Po kështu është parashikuar dhe në legjislacionin e Anglisë, e në legjislacione të tjera procedurale penale. P.sh., e drejta proceduralo-penale e Anglisë dhe doktrina në mënyrë kategorike e ndalon bërjen dhe drejtimin e pyetjeve të tilla. "Është me rëndësi, shkruan Murphy, që dëshmia direkte të përcillet nga dëshmitari me fjalët e tij dhe jo me ato të pyetësit dhe për pasojë, nuk lejohen pyetje drejtuese. Një pyetje drejtuese është një pyetje që e sugjestionon dëshmitarin, apo i sugjeron direkt përgjigjen që pyetësi pret prej tij" (14). Këtë qëndrim e mbajnë dhe autorë të tjerë anglezë. Pra në sistemin procedural akuzator, apo edhe në atë të përzier, siç e kemi edhe në vende të tjera në Evropë, pyetjet sugjestionuese janë të palejuara, por ka mendime nëse duhet të bëhen apo jo dhe që këtë të drejtë në gjykim e ka gjyqtari, që natyrisht në gjykim është gjyqtari që vendos se çfarë pyetjesh lejohen apo jo, por që ato sugjестive domosdo që nuk do të lejohen t'i drejtohen dëshmitarit apo të dëmtuarit në shqyrtimin gjyqësor, referuar ndalimit taksativ të ligjit dhe si të tilla nuk do të marrin përgjigje gjatë gjykimit, pavarësisht se kush i drejton ato: akuza, mbrojtja, apo i pandehuri. Ndërsa në hetimin paraprak, organi i procedimit duhet të bëjë kujdes, pasi pyetjet sugjestionuese, të ndaluara nga ligjëvënësi, mund ta çojnë atë jo drejt zbulimit të së vërtetës në procedimin penal, pasi këto pyetje drejtuar dëshmitarit apo të dëmtuarit të rritur, të mitur apo femrave, veç respektimit të standardeve të komunikimit e përcaktimit ligjor, në vendosjen e kontaktit psikologjik me të pyeturin, duhet të kenë parasysh dhe veçoritë psikologjike specifike të secilit prej tyre. Drejtimi i këtyre pyetjeve të ndaluara rreptësisht nga ligji, mund ta çojë të pyeturin në dhënien e përgjigjeve të dëshiruara nga organi i procedurës dhe për rrjedhojë, do të kemi përgjigje të pasakta, pasi dëshmitari apo i dëmtuari, duke u indikuar nga këto pyetje do të tregojë jo ato që ka dijeni, por ato që i kërkohen pas pyetjeve të tilla, edhe kur ai për shkak të ngjarjes së ndodhur apo faktorëve të tjerë, është i shqetësuar e se kujton faktin, apo nuk është i qartë për çka ka ndodhur në realitet.

Në pyetjen e dëshmitarit duhet treguar vëmendje e kujdes i veçantë, por specifikisht në pyetjen e të dëmtuarit nga vepra penale, pasi referuar praktikës së organeve të hetimit paraprak, tronditja e të dëmtuarit menjëherë pas kryerjes së veprës, ka raste që e pengon atë të perceptojë dhe të ruajë në kujtesë rrethana të rëndësishme të ngjarjes, dhe drejtimi i këtyre pyetjeve që servirin përgjigjen e orienton atë drejt thënieve të paqena, drejt plotësimit të mangësive të kujtesës, me çfarë ka dëgjuar nga të tjerë, që sjell prova të pasakta, të njëanshme e të pavlefshme e për rrjedhojë, bën që hetimi paraprak të devijojë nga zbulimi i së vërtetës në veprën penale të ndodhur apo të mbetur në tentativa.

Gjithsesi, në procedimin penal, sidomos në shqyrtimin gjyqësor, garancia e shpjegimeve të dëshmitarëve dhe verifikimi i plotë dhe i saktë i këtyre dëshmimeve, bëhet jo me pyetje sugjестive, por me zbatimin e parimit të barazisë së palëve dhe parimit të barazisë së armëve, si dhe shqyrtimit

të kryqëzuar të kësaj prove nga palët në gjykim. Duke u shqyrtuar prova e sipërme nëpërmjet një procesi gjyqësor të rregullt e të drejtë, do të arrihet në sqarimin e verifikimin e fajësisë apo pafajësisë së të akuzuarit, si dhe rrethanave të tjera që kanë të bëjnë me shkallën e përgjegjësisë së tij, ku të gjitha pyetjet që i drejtohen dëshmitarit nga palët pjesëmarrëse në gjykim dëgjohen, vlerësohen, e kur janë nga ato sugjестive të ndaluara nga ligji, nga gjykata nuk lejohen të bëhen dhe përfundimisht vendos ajo si arbitër i paanshëm, në shqyrtimin gjyqësor, si për çdo pyetje të drejtuar dëshmitarëve, që ato të mos ndikojnë në paanshinë e dëshmitarit ose që synojnë në sugjerimin e përgjigjeve, dhe në marrjen e një vendimi të ligjshëm e të drejtë.

Përfundime

Në veprimtarinë shumëvjeçare të organeve të procedimit penal, si gjatë hetimit paraprak dhe në shqyrtimin gjyqësor, objektivi i punës së tyre ka qenë e dhe mbetet zbulimi i së vërtetës dhe dhënia e një vendimi të drejtë, që vjen si rrjedhojë e konstatimit të fakteve të sigurta që kanë lidhje me veprën penale dhe autorin e saj. Dëshmia e dëshmitarit apo të dëmtuarit nga vepra penale, si një nga burimet e provave, e parashikuara nga legjislacioni penal, ka rëndësi për vërtetimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale, për zbulimin e motivit dhe fajësisë së autorit të saj. Zhvillimi i pyetjes së tyre nuk është vetëm një veprim proceduralo-penal, por edhe një proces psikik i ndërlikuar, pasi veprimtaria psikike e tyre zhvillohet në disa faza, deri në identifikimin e autorit, natyrisht nëpërmjet ndërtimit të një raporti psiko-ligjor gjatë marrjes në pyetje, sa më të mirë nga organi i procedimit si me dëshmitarin, dhe me të dëmtuarin, pasi ka ndodhur vepër penale. Kombinimi i kësaj veprimtarie, me zbatimin e dispozitave ligjore për një proces të rregullt ligjor, ka sjellë frytet e veta pozitive për zbulimin e veprave penale dhe autorëve të tyre, hetimin, dërgimin në gjyq e gjykimin e tyre sipas standardeve, duke rritur efektivitetin parandalues kundër kriminalitetit. Organet e procedimit në të ardhmen duhet të përdorin në procesin penal metodat më të përparuara psikologjike të komunikimit, duke angazhuar edhe psikologe brenda strukturave të tyre dhe teknologjinë më të avancuar të kohës, duke respektuar ligjin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Referenca

1. Latifi, Vesel Kriminalistika, f. 27, 38 Prishtinë, 2104.
2. Dragoti, Edmond Psikologjia Ligjore e Krimin f. 9, Tiranë, 2011.
3. Orhani, Zenel Psikologjia Konjuktive f. 107, Tiranë, 2005.
4. Engels, Frederik, Dialektika e Natyrës, f. 283 Tiranë, 1981.
5. Veseli, Latif, Kriminalistika, f. 169, Prishtinë, 2014.
6. Veliqoti, Luan, Identifikimi i personit në bazë të fotografisë, f. 64, Tiranë, 2009.
7. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, nenet 171-175, f. 89-91, Tiranë, 2009.
8. Kodi i Procedurës Penale Italiane, nenet 213-217, Romë, 2015.
9. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 120, f. 53, Prishtinë, 201.
10. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, neni 149, Tiranë, 2009.
11. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Tiranë, 1999.
12. Kodi i Procedurës Penale i RSH, neni 361/3, Tiranë, 2013.
13. Kodi i Procedurës Penale Italian, neni 499/2/3, Romë, 15. 05. 2017.
14. Murphy Peter, "Murphy on evidence" Oxford, 2005. f. 637, Tiranë, 2010.